



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 421/2023
Datë: 31 maj 2023

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafët 1.27 dhe 1.32 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nxjerr këtë:

VENDIM

- I. Shtyhet afati për shpalljen e konkursit për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Gjakovë i shpallur sipas vendimit KPK/Nr. 399/2023 i datës 23 maj 2023 deri në ndryshim/plotësimin e Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës.
- II. Obligohet Komisioni për Çështje Normative që të bëjë ndryshim/plotësimin e Rregullores Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës.
- III. Komisioni për Çështje Normative ndryshim/plotësimin e Rregullores Nr. 06/2019 obligohet ta dorëzojë për trajtim në takimin e radhës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- IV. Obligohet Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës që këtë vendim ta publikojë në uebportalin e sistemit prokurorial.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur me datë 23 maj 2023 ka nxjerr vendimin KPK/Nr. 399/2023 për shpalljen e konkursit për Kryeprokuror të Prokurorisë Themelore në Gjakovë nga data 1 qershor 2023.

Me datë 1 qershor 2023 do të hyjë në fuqi Ligji Nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit i cili ka paraparë kritere të tjera për përzgjedhjen e Kryeprokurorëve të Prokurorive Themelore në krahasim me ato të cilat kanë qenë të përcaktuara në ligjin paraprak dhe me Rregulloren Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës.

Me qëllim që procesi të realizohet në harmoni të plotë me legjislacionin në fuqi dhe duke pas parasysh që Rregullorja Nr. 06/2019 për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorëve të Prokurorive të Republikës së Kosovës është në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-167 për Prokurorin e Shtetit u vendos që të shtyhet afati i shpalljes deri në miratimin e rregullores me ndryshime e cila do të përcaktojë kriteret për emërimin e kryeprokurorëve.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'i dërgohet:

- Anëtarëve të Panelit Vlerësues;
- Anëtarëve të Komisionit për Rishqyrtim;
- Komisionit për Çështje Normative;
- Sekretariatit të KPK-së;
- NJSHPP-së;
- Arkivit të KPK-së.